



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIC OF KOSOVA**



**KOMUNA - MUNICIPALITY**  
**HANI I ELEZIT**

**DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA**

---

04 - Nr. 4269 /2014  
Hani i Elezit, 27.06.2014

# Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Hanit të Elezit për vitet 2015-2017

**HANI I ELEZIT, QERSHOR 2014**

## Lista e shkurtesave :

AK	Administrata Komunale
BE	Bashkimi Evropian
BRK	Buxheti i Republikës së Kosovës
BK	Buxheti i Komunës
BDMS	Sistemi i Zhvillimit dhe Menaxhimit të Buxhetit
BPV	Bruto Produkti Vendor
DBK	Departamenti i Buxhetit Komunal
DBF	Drejtoria e Buxhetit dhe Financave
DAP	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme
DAKRS	Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit
DSHMS	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
DSHPE	Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës
DUKMM	Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit
DBPZHR	Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
FKBRK	Fondi i Komunave nga Buxheti i Republikës së Kosovës
GP	Granti i Përgjithshëm
GSA	Granti Specifik i Arsimit
GSSH	Granti Specifik i Shëndetësisë
THVK	Të Hyrat Vetanake Komunale
THV	Të Hyrat Vetanake
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
KABK	Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale
KG	Komisioni i Granteve
KESH	Klasifikimi Ekonomik i Shpenzimeve
LFPL	Ligji i Financave të Pushtetit Lokal
LMFPP	Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi
LVQL	Ligji i Vetëqeverisjes Lokale
MF	Ministria e Financave
PIP	Programi për Investime Publike
PPP	Partneriteti Publiko – Privat
PRRU	Plani Rregullues Urban
PVPE	Plani i Veprimit për Partneritet Evropian
PZHK	Plani Zhvillimor Komunal
QBB	Qarkorja e Brendshme Buxhetore
RGJB	Rishikimi Gjashtëmuor i Buxhetit
ZK	Zyra e Kryetarit
ZKK	Zyra e Kuvendit të Komunës
ZKF	Zyrtari Kryesor Financiar

## Përmbajtja:

PJESA E PARË .....	5
1. SHQYRTIMET HYRËSE .....	5
2. KORNIZA AFATMESME E SHPENZIMEVE 2015-2017.....	6
2.1. Deklarata e Prioriteteve Afatmesme të Qeverisë 2015-2017.....	6
2.2. KORNIZA MAKRO -FISKALE 2015-2017.....	7
3. Burimet e Financimit Komunal për vitin 2015-2017.....	9
PJESA E DYTË.....	12
4. OBJEKTIVAT DHE PRIORITETET E KOMUNËS PËR VITET 2015-2017.....	12
5. KORNIZA FISKALE KOMUNALE PËR VITET 2015 – 2017.....	14
5.1. Perspektiva e Politikave Fiskale Komunale .....	15
6. KORNIZA E SHPENZIMVE BUXHETORE.....	18
6.1. Shpenzimet buxhetore sipas programeve dhe kategorive ekonomike të shpenzimeve .....	18
6.2. Shpenzimet komunale të shpërndara sipas kategorive dhe programeve - Viti aktual 2014...19	
6.3. Shpenzimet komunale të shpërndara sipas kategorive e dhe programeve - Viti 2015.....	20
6.4. Shpenzimet komunale të shpërndara sipas kategorive e dhe programeve - Viti 2016.....	21
6.5. Shpenzimet komunale të shpërndara sipas kategorive e dhe programeve - Viti 2017.....	22
6.6. Financimi i investimeve kapitale komunale 2015-2017.....	23
6.2. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike 2015-2017.....	25
6.2.1. Pagat dhe Mëditjet.....	25
6.2.2. Mallra dhe Shërbime dhe Shërbimet e Komunalisë .....	25
6.2.3. Subvencione dhe Transferet.....	25
6.2.4. Shpenzimet Kapitale .....	25
PJESA E TRETË .....	26
7. DEKLARATA PËR MISIONIN DHE PERFORMANSËN SIPAS DREJTORIVE .....	26
ZYRA E KRYETARIT .....	26
ZYRA E KUVENDIT KOMUNAL .....	28
DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME .....	29
DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA .....	30
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE EMERGJENCË .....	31
DREJTORIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL .....	32
DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK .....	33
DREJTORIA PËR URBANIZEM KADASTËR DHE MBROJTJE TË MJEDISIT.....	34
DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE .....	35
DREJTORIA PËR ARSIM, KULTURË, RINI E SPORT .....	36

## 1. SHQYRTIMET HYRËSE

Me procedurat e hartimit të dokumentacioneve përcjellëse të Buxhetit Afatmesëm të Komunës për periudhën e viteve 2015-2017, Komuna zyrtarisht ka filluar qysh nga data 16 maj 2014, atëherë kur nga Ministria e Financave është pranuar Qarkorja buxhetore 2015/01 për Komunat.

Me këtë Qarkore buxhetore, si zakonisht na janë ofruar udhëzimet e para, pastaj na është përcaktuar kalendari kohor indikativ si dhe kufijtë fillestar të financimit për përgatitjen e buxhetit të propozuar komunal dhe kërkesës për ndarje buxhetore për vitet 2015-2017.

Në aktivitetet tona gjatë përgatitjes dhe hartimit të draft - Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës (KABK), përveç që jemi bazuar në Qarkoren Buxhetore 2015/01 për Komunat, gjithsesi jemi shërbyer edhe me projeksionet e dhëna me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2015-2017 në nivel të vendit, si dhe në dokumentet e rëndësishme strategjike të komunës – Plani Zhvillimor Komunal (PZHK) dhe dhe Plani Rregullues Urban (PRRU).

Në përgatitjen e Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës 2015-2017, jemi bazuar edhe në legjislacionin përkatës nga kjo lëmi si:

- Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal - nr. 03/L-049
- Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit - nr. 03/L-048
- Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale - nr. 03/L-040 dhe
- Ligjin për Kufijtë Administrativ Komunal - nr. 03/L-060

Vlerësimet e hershme janë elementet kryesore në përgatitjen e projeksioneve indikative buxhetore për vitin 2015 dhe do të shërbejnë si projeksione për vitet 2016 dhe 2017. Vlerësimet e hershme janë në veçanti të rëndësishme për shqyrtimin adekuat të shpenzimeve operative dhe kapitale. Duhet ti kushtohet vëmendje kursimeve të cilat do të mund të identifikohen duke analizuar aktivitetet e përfunduara në vitet e kaluara dhe të cilat nuk do të përsëriten gjatë vitit vijues.

Për të ardhur deri te Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale ne kemi shfrytëzuar përvojat nga vitet e kaluara nëpërmes procesit buxhetor, ne kemi organizuar takim publik me qytetarët me datën 13.06.2014 për të diskutuar prioritetet dhe strategjitë e këtij dokumenti.

Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale ka përfshirë për vitet e ardhshme fiskale elementet në vijim:

- Parashikimet dhe supozimet ekonomike dhe buxhetore ;
- Totalët e vlerësuara të të hyrave nga të gjitha burimet e financimit nga grantet qeveritare, të hyrat vetanake komunale përfshirë participimin e qytetarëve, bashkëfinancimet nga ministritë e Kosovës dhe donacionet;
- Caqet totale për shpenzime në programe dhe nën-programe sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve për çdo vit buxhetor që të kontriboj në plotësimin e qëllimeve të cekura në strategjitë zhvillimore komunale;
- Vlerësimi i projekteve ekzistuese nga drejtoritë komunale duke i krahasuar me arritjen e prioritetëve dhe caqëve të caktuara nga strategjia zhvillimore komunale.
- Vlerësimet e mbështetjes së pritur të donacioneve dhe agjencive qeveritare ndërkombetare, përfshirë bashkëfinancimin e IPA-së.

## 2. KORNIZA AFATMESME E SHPENZIMEVE 2015-2017

## 2.1. Deklarata e Prioriteteve Afatmesme të Qeverisë 2015-2017

Prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës si pjesë e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2015-2017, janë të orientuara drejt zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, social dhe institucional të vendit. Prioritetet afatmesme 2015-2017, bazohen në Programin e Qeverisë, Deklaratën e Politikave Prioritare Afatmesme 2014-2016 dhe Planin e Veprimit për Negocimin e Marrëveshjes për Stabilizim Asociim. Në harmoni me prioritetet e përcaktuara përmes DPPA-së, KASH-i 2015-2017 merr parasysh edhe zotimet e Qeverisë së Kosovës në raport me institucionet ndërkombëtare. Në këtë kontekst KASH-i është hartuar në pajtim me politikat fiskale – buxhetore për të cilat Qeveria ka diskutuar dhe ka rënë në pajtim me Fondin Monetar Ndërkombëtarë (FMN). Duke u bazuar në këtë, procesi i zhvillimit buxhetor duhet të ketë parasysh respektimin e rregullës fiskale ku deficitin i përgjithshëm buxhetor nuk duhet të kalojë 2% të Bruto Prodhimit Vendor (BPV).

Qëndrueshmëria buxhetore dhe projeksionet makro-fiskale për periudhën afatmesme kanë rëndësi të veçantë në procesin e realizimit të prioriteteve të Qeverisë. Në këtë kontekst do të vazhdohet me ritmin e rritjes ekonomike, ruajtjen e deficitit të ultë buxhetor, nivelin e qëndrueshëm të borxhit publik të vendit, ngarkesës të ultë të biznesit me tatime si dhe rritjen e nivelit të grumbullimit të të hyrave brenda vendit në raport me ato që arkëtohen në kufi.

Krahas prioriteteve të përcaktuara me dokumentet kryesore strategjike, periudha afatmesme 2015-2017 përfshinë edhe disa vendime të rëndësishme të ndërmarra nga ana e Qeverisë. Këto politika përfshijnë rritjen e pagave për të gjithë shërbuesit publik, rritjen e pensioneve të të gjitha kategorive, pastaj ndarjen e mjeteve për skemat sociale dhe pensionale, duke përfshirë skemat e reja për ish të përndjekurit dhe burgosurit politik dhe veteranët e luftës. Për më tepër, për të realizuar këto prioritete Qeveria do të vazhdojë të financoj brenda kornizës buxhetore 2015-2017 sektorin e bujqësisë, reformat në shërbimin civil, investimet në infrastrukturën rrugore, duke përfshirë ndërtimin e Rrugës 6 dhe forcimin e rendit dhe sigurisë, të gjitha këto të integruara në një kornizë të qëndrueshme afatmesme buxhetore. Për të zbatuar këto politika, Qeveria gjatë periudhës së ardhshme afatmesme do të zvogëlojë ndarjet buxhetore për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve krahasuar me ndarjet për vitin 2014. Për më tepër, përmbushja e prioriteteve të Qeverisë përfshinë reformat e nevojshme në sektor të caktuar, përmes të cilave do të bëhet plotësimi i parakushteve ekonomike, sociale dhe institucionale në procesin e integrimi Euro-Atlantike dhe mekanizmat tjerë ndërkombëtarë. Në këtë kuadër, duke u bazuar në Programin e Qeverisë, prioritetet e Qeverisë janë përmbledhur në katër shtyllat e mëposhtme:

- Rritja dhe zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik;
- Qeverisja e mirë dhe politikat e sigurisë dhe mbrojtjes;
- Zhvillimi i kapitalit njerëzor;
- Rritja e standardit jetësor dhe mirëqenies sociale.

## 2.2 KORNIZA MAKRO - FISKALE 2015-2017

Analiza makroekonomike e cila mbështet planin fiskal tre vjeçar të elaboruar në këtë dokument parasheh rritje të të ardhurave vjetore për kokë banori nga 2,960 Euro më 2014, në 3,276 Euro më 2017. Me një mesatare afat-mesme inflacioni prej 1.1%, dhe rritje reale të BPV-së prej 4.4%, performanca makroekonomike në vitet vijuese pritet të jetë reflektim i ngritjes së përgjithshme të potencialit gjenerues të ekonomisë dhe jo vetëm i lëvizjeve ciklike përbrenda kapaciteteve ekzistuese. Udhëheqës të rritjes ekonomike pritet të jenë konsumi dhe investimet private, të përcjellura me mbështetje të eksportit dhe investimeve publike.

Mbi këtë performancë makroekonomike është zhvilluar edhe parashikimi i të hyrave buxhetore për periudhën 2015-2017. Të hyrat pritet të arrijnë në 1,598 milionë Euro më 2017, nga 1,458 milionë Euro sa janë buxhetuar më 2014. Nën parashikimet për shkallë të ulët inflacioni (dhe çmime rënëse të importit), kjo rritje që dominohet nga rritja e të hyrave tatimore pritet të vijë nga volumi i shtuar i aktivitetit ekonomik. Shpenzimet buxhetore të elaboruara më poshtë reflektojnë një sërë aktivitetesh dhe iniciativash të reja në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit sipas Deklaratës së Prioriteteve të hartuar për KASH 2015-2017. Deri më 2017 shpenzimet e përgjithshme pritet të arrijnë në 1,706 milionë Euro, nga 1,589 sa janë buxhetuar më 2014.

**Tabela1: Të hyrat buxhetore si dhe pjesëmarrja e tyre në BPV në miliona €**

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014 Buxheti	2015 Proj	2016 Proj	2017 Proj
<b>Te hyrat e pergjithshme:</b>	1,166.0	1,309.2	1,321.7	1,316.2	1,458.0	1,571.8	1,572.5	1,598.2
<b>si % e BPV-se</b>	29%	31%	28%	26%	27%	27%	26%	25%
<b>Te hyrat tatimore</b>	893.6	1,058.0	1,094.3	1,104.8	1,264.1	1,346.4	1,342.1	1,365.6
<b>si % e BPV-se</b>	21%	22%	22%	22%	23%	23%	22%	21%
<b>Te hyrat jo tatimore dhe vetanake</b>	147.9	162.6	145.4	168.4	192.5	195.0	200.4	202.6
<b>si % e BPV-se</b>	3%	3%	3%	3%	4%	3%	3%	3%

Burimi: MF, Departamenti i Thesarit, Departamenti i Buxhetit dhe Kalkulimet e DPEP

Në total, për periudhën 2015-2017, parashihet që arkëtimi kumulativ i të hyrave buxhetore të arrijë vlerën prej 4.74 miliardë euro, me 1.58 miliardë euro si mesatare vjetore. Pjesëmarrja e të hyrave në BPV përgjatë periudhës afat-mesme pritet të jetë mesatarisht 27%, me një pjesëmarrje mesatare të të hyrave tatimore në 23%. Pjesëmarrja e të hyrave tatimore në BPV parashihet të ulet gradualisht në 21% deri më 2017, pasi që në periudhën afatmesme politika fiskale pritet të akomodojë dy marrëveshje për tregëti të lirë (me Turqinë dhe Bashkimin Evropian), si dhe të ofrojë lehtësira fiskale për stimulimin e sektorit privat përfshirë këtu lirimet e aprovuara doganore për inputet në prodhim, stimuj tatimor për zonat e lira ekonomike, si dhe stimuj për thithjen e investimeve të huaja direkte. Si rezultat, parashihet që si përqindje ndaj aktivitetit të përgjithshëm ekonomik (BPV-së) barra tatimore të jetë më e ulët.

**Tabela 2: Struktura e të hyrave buxhetore, parashikimi 2015-2017, në miliona euro**

Përshkrimi	2011	2012	2013	2014 Buxheti	2015 Proj	2016 Proj	2017 Proj
<b>Të hyrat nga tatimet</b>	<b>1,058</b>	<b>1,094</b>	<b>1,105</b>	<b>1,264</b>	<b>1,346</b>	<b>1,342</b>	<b>1,366</b>
<b>Të hyrat tatimore vendore</b>	<b>261</b>	<b>284</b>	<b>305</b>	<b>367</b>	<b>430</b>	<b>436</b>	<b>443</b>
<b>Të hyrat tatimore doganore</b>	<b>825</b>	<b>845</b>	<b>837</b>	<b>934</b>	<b>958</b>	<b>949</b>	<b>969</b>
<b>Kthimet</b>	<b>-31</b>	<b>-35</b>	<b>-38</b>	<b>-37</b>	<b>-41</b>	<b>-42</b>	<b>-46</b>
<b>Te hyrat jo-tatimore dhe vetanake</b>	<b>163</b>	<b>145</b>	<b>168</b>	<b>193</b>	<b>195</b>	<b>200</b>	<b>203</b>
<b>Dividenda</b>	<b>60</b>	<b>45</b>	<b>43</b>	<b>-</b>	<b>30</b>	<b>30</b>	<b>30</b>
<b>Grantet e projekteve</b>	<b>0.1</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>1.0</b>	<b>0.3</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Fondi i mirëbesimit</b>	<b>9</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Të hyrat totale</b>	<b>1,309</b>	<b>1,322</b>	<b>1,316</b>	<b>1,458</b>	<b>1,572</b>	<b>1,572</b>	<b>1,598</b>

**-Të hyrat vendore** pritet të rriten nga 367 milionë euro, sa janë parashikuar me Buxhetin e vitit 2014, në 430 milionë euro më 2015. Kjo rritje prej 17% mbështetet në rritjen e të hyrave nga TVSH-ja dhe nga të hyrat e gjeneruara përmes tatimit të të ardhurave si rezultat i rritjes së përsheptuar ekonomike më 2014 (në veçanti rritjes së konsumit si rezultat i stimujve fiskal dhe zgjerimit kreditor, si dhe zëvendësimit të importit) dhe si rezultat i aktiviteteve për luftimin e ekonomisë jo-formale në vend.

**-Të hyrat doganore** pritet të rriten më 2015 me rreth 3% në krahasim me parashikimin e buxhetuar më 2014. Përkundër rënies së parashikuar të çmimeve të importit me 0.6% më 2015, rritja e të hyrave pritet të vijë nga kërkesa e shtuar për importe si rezultat i rritjes së konsumit dhe investimeve, ndonëse me trend më të ngadalësuar se ai historik për shkak të zëvendësimit evident të importit. Më 2016 të hyrat doganore pritet të jenë për 15 milionë euro më të larta se në vitin 2014, mirëpo për 9 milionë euro më të ulëta se në vitin 2015. Kjo për arsye se implementimi i marrëveshjes për tregti të lirë me BE-në dhe me Turqi pritet të ketë një efekt të njëhershëm, i cili më pastaj do kompensohet me rritje të volumit të importit më 2017, duke rezultuar në të hyra të parashikuara prej 969 milionë Euro, apo rreth 4% më shumë se sa parashikimi i buxhetuar për vitin 2014.

**-Të hyrat jo-tatimore, ato vetanake, dhe të hyrat tjera** ndonëse me potencial të gjerë për rritje, sidomos në nivelin komunal, janë parashikuar në mënyrë konzervative, duke ruajtur pjesëmarrjen e tyre konstante mesatarisht 3% të BPV-së (me një mesatare vjetore prej 199 milionë euro). Duhet theksuar se në parashikimin e kësaj kategorie të hyrash nuk është marrë për bazë stoku potencial i të hyrave që mund të gjenerohen nga legalizimi i objekteve në nivel komunal brenda periudhës afat-mesme, apo edhe ngritja e kapaciteteve për grumbullim të tatimit në pronë nga ana e komunave. Rënia në nivelin e të hyrave vetanake në nivelin qendror reflekton vendimin për lirimin e nivelit të pagesave për studentë si dhe trendin e të hyrave nga lëshimi i dokumenteve.

**Tabela 3. Struktura e shpenzimeve 2014-2017, në miliona euro**

Përshkrimi	2014 Buxheti	2015 Proj.	2016 Proj.	2017 Proj.
<b>Shpenzimet totale</b>	<b>1,589</b>	<b>1,678</b>	<b>1,679</b>	<b>1,706</b>
nga te cilat AKP	7	7	5	4
<b>Rrjedhese</b>	<b>1,050</b>	<b>1,196</b>	<b>1,207</b>	<b>1,215</b>
Pagat dhe medijtjet	483	550	552	554
Mallrat dhe shërbimet	252	211	215	215
Subvencionet dhe transferet	314	435	441	447
<i>Transferet sociale</i>	293	414	420	436
<i>Subvencionet per NP</i>	21	21	21	21
<b>Shpenzimet kapitale</b>	<b>530</b>	<b>461</b>	<b>450</b>	<b>470</b>
<b>Rezerva</b>	<b>2</b>	<b>5</b>	<b>5</b>	<b>5</b>
<b>Rezerva e pashpërndarë</b>	<b>193</b>	<b>16</b>	<b>16</b>	<b>16</b>
<b>Bilanci primar</b>	<b>131</b>	<b>106</b>	<b>106</b>	<b>108</b>
Pagesa e interesit	17	17	22	23
<b>Bilanci i përgjithshëm (sipas rregullës fiskale)</b>	<b>111</b>	<b>117</b>	<b>122</b>	<b>127</b>
<b>Bilanci i përgjithshëm</b>	<b>148</b>	<b>123</b>	<b>128</b>	<b>131</b>

Burimi: MF, Thesari dhe parashikimet e Departamentit të makroekonomisë

### 3. Burimet e Financimit Komunal për vitin 2015-2017

Financimi komunal përfshinë: Grantin e përgjithshëm, Grantin specifik për Arsim dhe Grantin specifik për Shëndetësi, përfshirë financimin për shëndetësi sekondare, grantet për kompetencat e shtuara, projeksionet e të hyrave vetanake të komunave, transferet për kompetencat e shtuara dhe deleguara, grantet e jashtëzakonshme, ndihma financiare nga jashtë. Grantet bazohen në kriteret e drejta, transparente dhe objektive, duke ju dhënë kështu komunave pavarësi më të madhe në alokimin dhe shpenzimin e tyre.

Ndërsa, aspekti i huamarrjes së komunave do të jetë si opcion i mundshëm i financimit që është paraparë në ligjin përkatës dhe në kuadër të rregullës fiskale të përcaktuar në LMFPP të dakorduar me Misionin e FMN-së.

Të gjitha të hyrat nga burimet në vijim janë të hyra vetanake të komunës: tatimi në pronë, taksat komunale, gjobat, tarifatat dhe pagesat në pajtim me autoritetin që u është dhënë komunave me LFPL.

**Tabela 4. Financimi komunal agregat për komuna për vitin 2015-2017 (mil. Euro)**

Përshkrimi	2011 Aktuale	2012 Aktuale	2013 Aktuale	2014 Aktuale	2015 Buxheti	2016 Parashik.	2017 Parashik.
<b>1. Grantet qeveritare</b>	<b>295.90</b>	<b>298.83</b>	<b>309.92</b>	<b>319.52</b>	<b>332.07</b>	<b>335.17</b>	<b>338.80</b>
<b>Granti i përgjithshëm</b>	<b>114.20</b>	<b>118.70</b>	<b>128.30</b>	<b>137.57</b>	<b>145.76</b>	<b>145.59</b>	<b>147.94</b>
<b>Granti i përgjithshëm bazë</b>				<b>127.80</b>			
Ndikimi nga regjistrimi i popullsisë 2011, sipas nenit 35 të LFPL				<b>9.77</b>			
<b>Granti specifik për shëndetësi</b>	<b>38.20</b>	<b>39.83</b>	<b>40.43</b>	<b>39.39</b>	<b>42.08</b>	<b>43.92</b>	<b>44.92</b>
<b>Granti specifik për arsim</b>	<b>143.50</b>	<b>140.30</b>	<b>141.19</b>	<b>142.56</b>	<b>144.23</b>	<b>145.66</b>	<b>145.94</b>
Financimi bazë	142.85	139.09	140.32	142.22	143.89	145.32	145.6
Politikat e reja dhe ne vazhdim:	0.65	1.21	0.87	0.34	0.34	0.34	0.34
Qendrat e ekselencës	0.04	0.43	0.87	0.34	0.34	0.34	0.34
Gjuha angleze	0.46	0.78					
Orët e kujdestarisë		-					
Pedagogët		0.15					
Arsimi joformal							
Kostoja e licencimit							
<b>2. Grantet për kompetencat e shtuara</b>	<b>2.85</b>	<b>2.60</b>	<b>2.60</b>	<b>1.85</b>	<b>2.60</b>	<b>2.60</b>	<b>2.60</b>
<b>Kujdesi shëndetësor dytësor</b>	<b>2.85</b>	<b>2.60</b>	<b>2.60</b>	<b>1.85</b>	<b>2.60</b>	<b>2.60</b>	<b>2.60</b>
<b>3. Transferi i Shërbimeve rezidenciale nga MPMS në Skenderaj dhe Graçanicë</b>	<b>-</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.24</b>	<b>0.24</b>	<b>0.24</b>	<b>0.24</b>
<b>4. Shërbimet rezidenciale</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>0.24</b>	<b>0.24</b>	<b>0.24</b>	<b>0.24</b>
Të hyrat vetanake komunale	51.88	60.00	63.00	67.23	74.24	75.63	76.80
<b>5. Financimi kontingjent për decent.</b>	<b>1.50</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
MAPL (komunat e reja)	1.50	-	-	-	-	-	-
<b>6. TOTAL FINANCIMI KOMUNAL</b>	<b>352.13</b>	<b>361.43</b>	<b>375.52</b>	<b>388.84</b>	<b>409.16</b>	<b>413.64</b>	<b>418.44</b>
<b>7. Kontigjenca nga Buxheti Qendror për financimin e rritjes së pagave 25%</b>					<b>10</b>		
<b>8. TOTAL FINANCIMI KOMUNAL, përfshirë kontigjencën e pagave</b>	<b>352.13</b>	<b>361.43</b>	<b>375.52</b>	<b>388.84</b>	<b>419.16</b>	<b>413.64</b>	<b>418.44</b>

**Koment:** kostoja e rritjes së pagave 25% për komunat sipas Vendimit të Qeverisë, bazuar në kalkulimin e Payroll / MAP është 42,597,672 euro. Kontigjenca nga Buxheti Qendror për financimin e rritjes së pagave të nivelit komunal është 10,000,000 Euro.

**Tabela – 5. TOTAL FINANCIMI KOMUNAL PËR VITIN 2015**

Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Hanit të Elezit për vitet 2015-2017

Nr	Komuna	Granti i përgjithshëm	Granti specifik për Arsim parauniversitar	Granti specifik për shëndetësi primare	Shëndetësia sekondare	Financimi i Shërbimeve rezidenciale	Të hyrat vetanake komunale	Total financimi komunal për vitin 2015
1	Deçan	3,197,970	2,335,075	946,169			636,892	7,116,106
2	Dragash	3,394,042	2,302,135	803,791			487,030	6,986,998
3	Ferizaj	8,184,958	10,151,546	2,567,866			4,204,689	25,109,059
4	Fushë Kosovë	2,823,176	2,377,659	823,415			1,822,756	7,847,006
5	Gjakovë	7,487,928	7,004,055	2,235,588			3,026,311	19,753,882
6	Gjilan	6,854,173	8,434,193	2,132,078			3,859,953	21,280,397
7	Glllogoc	4,458,511	4,776,086	1,383,848			1,200,874	11,819,319
8	Hani i Elezit	865,478	657,149	222,315			256,258	2,001,200
9	Istog	3,369,804	3,046,842	928,910			1,014,149	8,359,705
10	Junik	624,322	390,710	143,844			91,567	1,250,443
11	Kaçanik	2,647,217	2,543,525	789,889			695,757	6,676,388
12	Kamenicë	3,073,614	2,552,349	853,158			986,433	7,465,554
13	Klinë	3,127,917	3,235,182	910,161			857,767	8,131,027
14	Leposaviq	2,170,664	756,462	325,635			42,888	3,295,649
15	Lipjan	4,563,123	4,788,278	1,361,955			1,342,336	12,055,692
16	Malishevë	4,207,847	5,734,881	1,291,215			755,908	11,989,851
17	Mamusha	818,191	359,283	130,202			64,869	1,372,545
18	Mitrovicë	5,523,924	5,942,343	1,700,144			2,117,292	15,283,703
19	Novo Bërdë	897,591	673,459	159,094			204,672	1,934,816
20	Obiliq	1,797,298	1,786,246	509,483			811,716	4,904,743
21	Pejë	7,698,527	7,244,248	2,280,367			3,394,551	20,617,693
22	Podujevë	6,869,251	7,296,487	2,092,382			1,597,592	17,855,712
23	Prishtinë	14,699,843	15,042,433	4,702,522			27,162,609	61,607,407
24	Prizren	14,356,806	12,962,591	4,203,276			8,275,080	39,797,753
25	Rahovec	4,332,840	4,413,520	1,328,926			1,099,014	11,174,300
26	Shtërpçë	946,649	924,102	164,295	522,371		336,282	2,893,699
27	Shtime	2,193,109	2,438,510	646,021			445,503	5,723,143
28	Skenderaj	4,000,159	4,977,597	1,202,436		133,000	748,155	11,061,347
29	Suharekë	4,629,414	5,104,092	1,412,007			2,117,200	13,262,713
30	Viti	3,653,448	3,898,703	1,110,914			1,008,847	9,671,912
31	Vushtrri	5,343,079	5,596,231	1,651,936			1,675,327	14,266,573
32	Zubin Potok	1,206,609	379,176	156,422			42,888	1,785,095
33	Zveqan	1,118,441	323,938	176,873			42,888	1,662,140
34	Graçanicë	1,614,815	1,385,453	252,389	1,090,771	110,000	1,501,093	5,954,521
35	Klllokot	384,206	235,022	60,432			86,849	766,509
36	Mitrovica e Veri	1,606,553	1,450,219	291,424	989,935		90,066	4,428,197
37	Partesh	369,860	318,281	42,250			46,384	776,775
38	Ranillug	648,646	392,269	91,404			92,768	1,225,087
	<b>TOTAL</b>	<b>145,760,003</b>	<b>144,230,330</b>	<b>42,085,036</b>	<b>2,603,077</b>	<b>243,000</b>	<b>74,243,213</b>	<b>409,164,659</b>

Kontigjenca nga Buxheti Qëndror për rritjen e pagave 25 % për Nivelin Komunal	10,000,000
<b>Total Financimi Komunal</b>	<b>419,164,659</b>

## PJESA E DYTË

### 4. OBJEKTIVAT DHE PRIORITETET E KOMUNËS PËR VITET 2015-2017

#### ❖ Objektivat e Komunës së Hanit të Elezit:

- Mbrojtja, përmirësimi i ambientit dhe infrastrukturës së Hanit të Elezit
- Hartimi i hartave zonale
- Zhvillimi i sferës së Shëndetësisë dhe Mirëqenies sociale
- Ngritja e nivelit të Arsimit dhe Edukimit
- Zhvillimi i sferës së Kulturës, Rinisë dhe Sportit
- Zhvillimi i turizmit rural.

#### **Objektivat:**

##### a) Shtimi i efikasitetit gjatë operacioneve

- Përmirësimi i efektivitetit në shpenzimin e buxhetit komunal
- Shfrytëzimi maksimal i burimeve
- Respektimi i afateve kohore gjatë kryerjes së punëve
- Kryerja e punëve në mënyrë të duhur
- Përzgjedhja e punëve me prioritet për realizim

##### b) Rritja e shpejtë e të ardhurave

- Rritja e efikasitetit në inkasim
- Zgjerimi i bazës tatimore

##### c) Kontrolli i shpenzimeve dhe reduktimi i shpenzimeve

- Evitimi i shpenzimeve të panevojshme
- Planifikimi i shpenzimeve me kohë
- Përparësia nga blerja me shumicë
- Planet për kursim nga shpenzimet

##### d) Zhvillimi i aftësive

- Trajnimi për burimet njerëzore
- Përdorim i gjerë i kompjuterit
- Profesionalizimi i shërbimeve

##### e) Të sigurohet disiplina financiare

- Pajtueshmëria me politikën financiare, rregullat, rregulloret dhe me udhëzimet
- Transparenca gjatë sjelljeve të vendimeve, informimi publik përmes web-faqes komunale
- Analizat të vazhdueshme dhe sipas kërkesave të shpenzimeve
- Realizimi i Buxhetit sipas planit të rrjedhjes së parasë së gatshme (Kesh Plani)


f) *Ekonomia*

- Zhvillimi i strategjisë Komunale për promovim ekonomik
- Krijimi i kushteve për investime të huaja
- Strategjia për zhvillimin rural të turizmit

**Programet**

 ***Shqyrtimi dhe përmirësimi i sistemeve operative dhe transparencë***

- Shënimet e duhura financiare dhe procedurat e kontabilitetit
- Koordinimet në mes departamenteve
- Përmirësimi i mbledhjes së të dhënave dhe analizat
- Menaxhimi i bazës së të dhënave dhe përhapja e informatave

 ***Përmirësimi i bazës së të ardhurave (të hyrave)***

- Arkëtim më të madh të tarifave dhe ngarkesave që janë për t'u paguar
- Sa më shumë tatimpagues në rrjetin e tatimeve
- Ngarkesa (çmime) të reja për shërbime të reja
- Çmime (ngarkesa) të ndryshme

 ***Ristrukturimi organizativ***

- Shqyrtimi i strukturës organizative

**Veprimet që kanë të bëjnë me objektivat**

- Zbatimi i rregulloreve komunale
- Kujdesi ndaj palëve në Qendrën për shërbim të qytetarëve
- Përgatitja e buxhetit dhe planit të punës 2015
- Përgatitja e Kornizës afatmesme të shpenzimeve 2015-2017
- Shqyrtimi i përgjegjësive dhe i obligimeve komunale
- Menaxhimi i projekteve
- Menaxhimi i bazës së të dhënave
- Monitorimi
- Vlerësimi

## 5. KORNIZA FISKALE KOMUNALE PËR VITET 2015 - 2017

Korniza fiskale komunale apo Korniza e të hyrave komunale përfshinë pjesën e buxhetit komunal nga aspekti i parashikimit të të hyrave të përgjithshme komunale për sigurimin e mjeteve për financimin e shpenzimeve të komunës për periudhën e viteve 2015-2017.

Projeksionet në kornizën fiskale komunale për vitet 2015-2017, janë të bazuara në përputhshmëri të plotë me kufijtë buxhetor me Qarkoren Buxhetore nr.2015/01 për Komunitat dhe me parashikimet e miratuara me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2015-2017 në nivel të vendit.

Një vëmendje e veçantë duhet kushtuar politikave fiskale (politikës së të ardhurave si nga granti i qeverisë, të hyrave vetanake komunale si dhe shpenzimeve).

Për vitin fiskal 2015 parashohim një buxhet prej 2,001,200€apo një rritje prej 126,505 €ose për afër 6.75 % më i madh në raport me vitin 2014, kurse për vitin 2016 kemi një buxhet prej 2,019,989 €apo një rritje prej 18,789 €ose për afro 0.94% në raport me vitin 2015, si dhe për vitin 2017 parashohim një buxhet prej 2,044,746 €apo një rritje prej 24,757 €ose për afro 1.23% më i madh në raport me vitin 2016.

Analizuar financimin sipas llojeve të granteve qeveritare, në periudhën vijuese 2015-2017, trende të rritjes do të shënoj financimi nga **Grant i përgjithshëm (GP)**, pasi që nga shuma prej 772,611€ sa ishte në vitin buxhetor 2014, në vitin e parë buxhetor 2015 do të kemi në dispozicion shumën prej 865,478 €apo një rritje 92,867 €ose për afër 12%.

**( Shkalla mesatare e rritjes për periudhën 2015-2017, parashikohet prej 4.44% në vit ).**

Te Granti Specifik i Arsimit, i cili financim qeveritar ka si kriter kryesor numrin e nxënësëve, në vitin 2015 parashikohet të jetë në shumë prej 657,149 €ose një rritje simbolike prej 0.94% apo për vetëm 6,097 €( në vitin 2014 është në shumë prej 651,052 €).

**( Shkalla mesatare e rritjes për periudhën 2015-2017, parashikohet prej 0.81% në vit ).**

Po ashtu, në saje të aplikimit të kriterëve të reja si (2.5 vizita për kokë banori me një kosto prej 4 €për vizitë dhe 3.5 shërbime për kokë banori me një kosto prej 3.9 €per shërbime), trende të rritjes kemi edhe te **Granti Specifik i Shëndetësisë** nga shuma prej 208,083 €sa ishte në vitin 2014, në 222,315 €në vitin 2015 apo një rritje për 14,232 €ose për 6,84%.

**( Shkalla mesatare e rritjes për periudhën 2014-2016, parashikohet prej 4.49% në vit ).**

Ndërsa, **Të hyrat vetanake komunale (THVK)** në vitin pauses 2015, parashikohen të jenë në lartësi prej 256,258 €ose një rritje për 5.48% në raport me vitin 2014 (242,949 €), duke u planifikuar një rritje në masë monetare për 13,309 €

**( Shkalla mesatare e rritjes për periudhën 2015-2017, parashikohet prej 2.80% në vit ).**

## 5.1. Perspektiva e Politikave Fiskale Komunale

Në hartimin e perspektivës së politikave fiskale komunale jemi bazuar në informatat dhe analizat e KASH-it 2015-2017, në të cilin dokument projektionet makro-fiskale parashohin një përmirësim të konsiderueshëm në vjeljen e të hyrave vetanake komunale (THVK), në rritjen e efikasitetit të shpenzimeve të parasë publike, në zbatimin e kursimeve buxhetore, etj.

Financimi komunal nga të hyrat vetanake komunale për vitin 2015, të parashikuar në KAB Komunale 2015-2017, bazohet në dispozitat e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal.

Të hyrat vetanake komunale për vitin 2015 dhe projektionet për vitet 2016-2017, përfshijnë të hyrat e planifikuara të cilat janë aprovuar nga Komisioni i Granteve në shume prej 74,243,213 €

**Tabela – 6. Projektionet e të hyrave vetanake nga Komunitat për vitin 2015-2017 në mil. €**

Projektimi (mil €)	Viti 2011	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017
<i>Të hyrat vetanake të komunave</i>	51.88	60.00	63.00	67.23	74.24	75.62	76.80

**Tabela -7. Të hyrat e gjithëmbarshme buxhetore komunale për periudhën e viteve 2014 - 2017**

Burimet e të hyrave	Buxheti 2014	Planifikimi 2015	Parashikimi 2016	Parashikimi 2017
<b>Granti i Përgjithshëm</b>	772,611	865,478	864,598	876,750
<b>Granti i Arsimit</b>	651,052	657,149	663,705	666,897
<b>Granti i Shëndetësisë</b>	208,083	222,315	232,008	237,291
<b>Gjithsej financimet qeveritare</b>	<b>1,631,746</b>	<b>1,744,942</b>	<b>1,760,311</b>	<b>1,780,938</b>
<b>Të hyrat vetanake</b>	242,949	256,258	259,678	263,808
<b>Gjithsej të hyrat vetanake</b>	<b>242,949</b>	<b>256,258</b>	<b>259,678</b>	<b>263,808</b>
<b>Gjithsej të hyrat komunale</b>	<b>1,874,695</b>	<b>2,001,200</b>	<b>2,019,989</b>	<b>2,044,746</b>

Duke u bazuar në trendet makro-ekonomike dhe projektionet e dhëna në nivel të vendit dhe bazës së të dhënave numerike në vlerësimet tona të hershme buxhetore për periudhën 2015-2017, Buxheti i i komunës do të shënoj trende të vazhdueshme të rritjes prej vitit në vit, ndërsa vetëm në vitin 2015, në raport me buxhetin aktual 2014, do të shënoj rritje në masë monetare për 126,505 € ose një rritje prej 6.75%.

Në vitin 2016 do të kemi një rritje të lehtë prej vetëm 0.94% ose për 18,789 € në raport me vitin paraprak 2015, si dhe në vitin e fundit 2017, përsëri kemi një rritje të lehtë, një rritje e matur prej vetëm 1.23% ose në masë monetare shuma prej 24,757 € përballë vitit 2016.

Në vitin e parë buxhetor 2015 sipas këtyre parametrave, do të kemi këtë strukturë buxhetore të sigurimit të mjeteve: pjesëmarrja me **87.19% nga të hyrat nga Granti qeveritar dhe 12.81% nga Të Hyrat Vetanake Komunale.**

**Shikuar sipas viteve dhe strukturës së burimeve të mjeteve, në vazhdim prezantojmë këtë pasqyrë tabelare:**

**Tabela - 8. Plani Afatmesëm i të hyrave totale të buxhetit komunal për vitet 2015-2017**

Nr	Përshkrimi	Buxheti aktual 2014	Plani 2015	Vlerësimi 2016	Vlerësimi 2017
a	B	C	d	e	f
<b>1</b>	<b>TË HYRAT KOMUNALE TOTALE</b>	<b>1,874,695</b>	<b>2,001,200</b>	<b>2,019,989</b>	<b>2,044,746</b>
<b>1.1</b>	<b>TË HYRAT VETANAKE KOMUNALE</b>	<b>242,949</b>	<b>256,258</b>	<b>259,678</b>	<b>263,808</b>
<b>1.1.1</b>	<b>Tatimi në pronë</b>	<b>91,240</b>	<b>93,250</b>	<b>94,670</b>	<b>97,650</b>
<b>1.1.2</b>	<b>Taksat komunale</b>	<b>119,259</b>	<b>124,458</b>	<b>125,308</b>	<b>126,058</b>
	<i>Licencat dhe lejet</i>	90,609	92,608	92,808	92,958
	<i>Çertifikatat dhe dokumentet zyrtare</i>	4,150	4,350	4,500	4,600
	<i>Taksat e regjistrimit e mjeteve motorike</i>	14,000	14,000	14,000	14,000
	<i>Lejet për ndërtesa</i>	6,000	7,000	7,500	8,000
	<i>Taksat tjera komunale</i>	4,500	6,500	6,500	6,500
<b>1.1.3</b>	<b>Ngarkesat komunale</b>	<b>29,450</b>	<b>34,850</b>	<b>35,800</b>	<b>36,100</b>
	<i>Ngarkesat rregullatore</i>	14,300	17,000	17,800	18,000
	<i>Të hyrat nga qiraja</i>	6,000	6,000	6,000	6,000
	<i>Bashkë-pagesat për arsim</i>	-	-	-	-
	<i>Bashkë-pagesat për shëndetësi</i>	5,150	5,350	5,500	5,600
	<i>Ngarkesat tjera komunale (gjobat)</i>	4,000	6,500	6,500	6,500
<b>1.1.4</b>	<b>Të hyrat tjera</b>	<b>3,000</b>	<b>3,700</b>	<b>3,900</b>	<b>4,000</b>
<b>1.2</b>	<b>TRANSFERET QEVERTARE</b>	<b>1,631,746</b>	<b>1,744,942</b>	<b>1,760,311</b>	<b>1,780,938</b>
1.2.1	<i>Granti i Përgjithshëm</i>	772,611	865,478	864,598	876,750
1.2.2	<i>Granti specifik i Arsimit</i>	651,052	657,149	663,705	666,897
1.2.3	<i>Granti specifik për Shëndetësi</i>	208,083	222,315	232,008	237,291

Të hyrat buxhetore komunale realizohen në bazë të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, Rregullores për Taksat, Tarifat dhe Ngarkesat Komunale, Rregullorës së Tatimit në Pronë si dhe dispozitave tjera ligjore të cilat përcaktojnë llojet e ndryshme të të hyrave komunale me të cilat komuna është e autorizuar dhe ka të drejtë t'i inkasoj.

Bazën e të hyrave komunale e përbëjnë Tatimi në Pronë, si gjenerator kryesor i të hyrave vetanake komunale (THVK), e që këtë lloj të hyre komuna pas grumbullimit duhet ekskluzivisht të shpenzoj vetëm për qëllime të realizimit të projekteve kapitale si, në infrastrukturë rrugore, në ujësjellëse, kanalizime dhe investime e tjera, që thenë ndryshe këto mjete pas inkasimit menjëherë iu rikthehen qytetarëve apo tatimpaguesëve përmes formës së investimeve të destinuara për ngritjen e infrastrukturës komunale dhe mirëqenjes sociale.

**Të hyrat e komunës përbëhen kryesisht nga këto lloje të të hyrave:**

- Tatimi në Pronë,
- Taksat për ushtrim te veprimtarisë së biznesit
- Taksat për leje të ndërtimit,
- Taksa për shfrytëzimin e pronës komunale,
- Taksa për regjistrimin e automjeteve motorike,
- Taksat administrative komunale (taksa për dokumentacionin lidhur me statusin shoqëror si, çertifikatat e lindjes, martesës, shtetësisë etj.),
- Bashkë-pagesat në arsim,
- Bashkë-pagesat në shëndetësi, dhe
- Të hyra tjera ( gjobat direkte dhe indirekte ).

Përveç të hyrave nga Tatimi në Pronë, kemi edhe taksat tjera komunale të cilat kontribuojnë dukshëm në krijimin e THVK, si: Taksat për ushtrim te veprimtarisë së biznesit, taksa për regjistrimin e automjeteve motorike, taksat për shfrytëzimin e pronës komunale, taksa për lejet e ndërtimit, etj.

Duke u bazuar në të dhënat e prezentuara në Tabelën 8 – Plani afatmesëm i të hyrave totale të buxhetit komunal, THVK për vitin aktual buxhetor 2014 janë të planifikuar në shumë prej 242,949 € ndërkaq për vitet vijuese 2015-2017, përkatësisht në vitin e parë të planifikimit afatmesëm 2015, parashikohen që THVK-të të jenë në masë prej 256,258 € ose një rritje prej 5,48% ne raport me 2014, pastaj në vitin 2016 në shumë prej 259,678 ose një rritje në raport me vitin 2015 prej 1.33% dhe në vitin e tretë 2017 shuma prej 263,808 € ose 1.59% një shtim i të hyrave në krahasim me vitin 2016.

Mbështetur në të dhënat e pasqyruara në tabelarë dhe nga e gjithë kjo që u potencua, mund të konstatohet se përmbushja e të hyrave të përgjithshme buxhetore komunale për periudhën e ardhshme afatmesme 2015-2017, krahas varshmërisë së mëtejme që do të kemi nga alokimet e Granteve qeveritare, gjithësesi do të jemi të varur edhe nga shkalla e realizimit të të hyrave direkte komunale, e që këto të fundit kanë ndikim edhe në shkallën e ekzekutimit të investimeve kapitale, të cilat do të financohen nga ky burim i të hyrave.

## 6. KORNIZA E SHPENZIMVE BUXHETORE

### 6.1. Shpenzimeve buxhetore sipas programeve dhe kategorive ekonomike të shpenzimeve

Me vlerësimet e hershme të shpenzimeve buxhetore, në KAB Komunale për 2015-2017, janë të përfshira projeksionet orientuese sipas programeve dhe nënprogrameve buxhetore mbi bazën e ndarjës së re buxhetore në pesë (5) kategori kryesore të shpenzimeve për tre vitet e ardhshme të shpenzimeve të përgjithshme të komunës.

Këto projeksione dhe vlerësime të shpenzimeve buxhetore për vitet 2015-2017, janë të bazuara në politikat dhe prioritet e përcaktuara më parë nga programet buxhetore dhe konsolidimi i tyre në nivel të organizatës buxhetore të komunës.

Për vitet 2015-2017, shpenzimet e përgjithshme operative buxhetore do të përqëndrohen para se gjithash në mbulimin e shpenzimeve nga ushtrimi i kompetencave komunale dhe funksionimin sa më efikas të tre (3) sektorëve publik si, të administratën publike, arsimit dhe shëndetësisë me mirëqenje sociale.

Ndërsa, te shpenzimet kapitale bazuar në kërkesat e parashtruara nga programet buxhetore, do të bëhen përpjekjet maksimale në sigurimin e mjeteve buxhetore për vitet 2015-2017, duke u krijuar një konsum investiv me një pjesmarrje në strukturën e shpenzimeve të përgjithshme buxhetore të komunës prej 21% në vitin 2015 dhe në vitin 2017 me një participim prej 22,7% ose një rritje strukturale prej 1.7 poena indeksi.

Në sferën e realizimit të projekteve kapitale 2015-2017, rëndësi e posaçme do t'i kushtohet edhe Bashkëpunimit me donatorët për shtimin e masës së mjeteve për investime kapitale, për bashkëfinancim të projekteve investive publike.

Tabela – 9

## 6.2 Shpenzimet komunale të shpërndara sipas kategorive dhe programeve -Viti 2014

Nën-programi	Përshkrimi	Stafi	Pagat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimet kapitale	Total
a	b	c	d	e	f	g	h	i
16035	Zyra e Kryetarit	7	41,234	20,000	-	14,000	-	75,234
16935	Zyra e Kuvendit Komunal	-	48,500	1,500	-	-	-	50,000
16335	Administrata dhe personeli	17	70,764	44,813	19,000	-	-	134,577
17535	Buxheti dhe financat	11	40,320	4,000	-	-	-	44,320
18444	Shërbimet publike, emergjenca	8	40,586	18,000	-	-	122,000	180,586
19675	Zyra e komuniteteve	1	3,892	2,000	-	-	-	5,892
47115	Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi rural	6	18,218	3,000	-	11,500	-	32,718
48035	Zhvillimi ekonomik	3	11,784	2,000	-	-	-	13,784
66480	Planifikimi urban dhe mjedisi	7	34,927	4,000	-	-	287,158	326,085
